

< Sent



To: Shyqiri Bytyqi > Arber Geci >

Hide

Ekrem Kastrati > Baton Dushi >

From: Kumrije Gatica >

**Njoftim per mos validim të të gjitha
studimeve dhe diplomave të studentëve të
Librave Amëz të dorëzuara jashtë afateve
ligjore!**

Today at 08:13

I nderuar Ministër, z. Shyqiri Bytyqi,
I nderuar Zëvendësministër, z. Arbër Geci,
I nderuar Sekretar i Përgjithshëm, z. Ekrem
Kastrati,
I nderuar Shef i Kabinetit dhe Këshilltar i Lartë
Politik, z. Baton Dushi,

Bashkëlidhur në këtë e-mail po iu dërgoj raportin lidhur me gjendjen faktike të Librave Amëz të Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (BPrAL). Arsyeja e këtij raporti është rinjoftimi dhe përsëritja e ngritjes së çështjes për shkeljet ligjore nga kolegjet private lidhur me dorëzimin e librave amëz. Siç edhe jeni të njoftuar disa nga kolegjet private nuk i kanë respektuar dispozitat ligjore duke mos dorëzuar kopjet e librave amëz në MASHT sipas afateve ligjore që është e përcaktuar me Udhëzim Administrativ për Librat Amëz të Institucioneve të Arsimit të Lartë.

Përveç afatit të dorëzimit, i cili e konteston validitetin e studimeve të studentëve të listuar në këto libra amëz ka edhe parregullsi tjera kur BPrAL-të nuk i kanë respektuar dispozitat ligjore të përcaktuara me legjislacionin relevant, sikurse që numri i kopjes së librit amëz nuk përputhet me listat e dorëzuara elektronike; ose kur është dërguar lista elektronike, nuk është dorëzuar kopja e librit amëz në MASHT, përkatësisht listat e dorëzuara në MASHT nuk janë mbyllur dhe verifikuar me nënshkrim dhe vulë, ose rastet kur kopja e librit amëz është lënë tek individ të caktuar dhe jo kompetent në MASHT duke mos u dorëzuar zyrtarisht, pa u protokolluar përmes arkivës.

Në disa raste kopja e librit amëz e dorëzuar në MASHT nuk përputhet me numrin e studentëve të librit origjinal të cilin e posedon BPrAL; Ka raste kur në librin amëz nuk janë evidentuar studentët e regjistruar etj (Më detajisht iu lutemi iu referoheni raportit të bashkëlidhur). Origjinali i Librit Amëz i cili është në BPrAL duhet të jetë identik me listën elektronike dhe me kopjen e librit amëz të dorëzuar si të vërtetuar dhe protokolluar në MASHT. Për të gjitha këto shkelje ligjore nga kolegjet, ka qenë i njoftuar me shkrim ish Drejtori i Arsimit të Lartë, ish Sekretari i Përgjithshëm, Kabineti i Ministrisë dhe Departamenti i Inspeksionit - i cili nuk ka marrë asnjë masë të përcaktuar me ligj për këto shkelje.

Nga momenti që përgjegjësia e verifikimit dhe vulosjes së dokumentacionit përkatës ka kaluar në NARIC, kemi pasur raste kur Inspektorët pa lejen e NARIC-ut kanë bërë inspektime individuale dhe kanë kërkuar që ti vulosim diplomat e studentëve që nuk kanë qenë të evidentuar në librat amëz të pa vërtetuara dhe të pa protokolluara zyrtarisht, konform procedurës relevante në MASHT. Për Divizionin e NARIC të gjitha Librat Amëz me emra të studentëve që janë dorëzuar në MASHT duke mos u ndjekur afatet dhe procedurat e pranimit-dorëzimit ligjor nuk konsiderohen valide. Për rrjedhojë edhe studimet e studentëve të evidentuar në këta libra amëz, nuk mund të konsiderohen valide. Tashmë jemi njoftuar gojarisht (jo përmes emailit ose ndonjë forme tjetër zyrtare) se është krijuar një grup punues i cili pretendon t'i bëjë valid librat amëz të dorëzuar në MASHT jashtë çdo afati dhe në procedurë jo ligjore. Rrjedhimisht diplomat e tyre në asnjë mënyrë nuk mund të vulosen dhe të nënshkruhen nga NARIC.

Me këtë rast si udhëheqëse e këtij Divizioni, duke marrë për bazë dokumentacionin e mangët të kolegjeve të dorëzuar në MASHT, dhe tolerimi i veprimtarisë së tyre në kundërshtim me dispozitat relevante ligjore paraqet mos përfillje të plotë të dispozitave ligjore të dala nga legjislacioni primar dhe sekondar.

Aq më tepër nëse nxirret ndonjë vendim që këto diploma dhe studime të njihen në mënyrë retroaktive.

Sinqerisht,